Përmbajtja

1 Shpjegimi i simboleve dhe udhëzimet e sigurisë 205
1.1 Shpjegimi i simboleve 205
1.2 Kështilla të përgjithshme sigurie 205
1.3 Shënimet në këtë manual 206

2 Të dhëna për produktin 206
2.1 Deklarata e konformitetit 206
2.2 Të dhënat teknike të telekomandës 206
2.3 Përdorimi me kondicioner Multi-Split 206
2.4 Specifikimet e portëkalimit IP 206

3 Përdorimi 207
3.1 Përmbledhje e njësisë së brendshme 207
3.2 Përmbledhje e telekomandës 207
3.3 Përdorimi i telekomandës 208
3.4 Lidhjet 208
3.4.1 Lidhjet 208
3.4.2 Mbështetja për Matter 209
3.4.3 Funksioni i monitorimit të energjisë 209
3.5 Caktimi i modalitetit kryesor 209
3.6 Konfigurimi i kohëmatësit 209
3.7 Funksionet kryesore të operimit 210
3.7.1 Funksioni i kursimit të energjisë 210
3.7.2 Caktimi i funksionit të lëkundjes 210
3.7.3 Turbo cool/Turbo heat 210
3.7.4 Silent Mode 210
3.7.5 Modaliteti i fjetjes 211
3.7.6 Funksioni i siguresë së fëmijëve 211
3.7.7 Mbrojtje nga ngrica (8 °C / 12 °C) 211
3.7.8 Funksione të tjera 211

4 Zgjidhja e problemeve 212
4.1 Gabimet me tregues (Self diagnosis function) 212
4.2 Gabime pa tregues 212

5 Mirëmbajtja 213
5.1 Ndërrimi i baterive 213
5.2 Pastrimi i pajisjes dhe i telekomandës 213
5.3 Pastrimi i filtrit të ajrit 213
5.4 Lënia pa punë për kohë më të gjatë 213
5.5 Puna manuale 213

6 Mbrojtja e ambientit dhe hedhja 214

1 Shpjegimi i simboleve dhe udhëzimet e sigurisë

1.1 Shpjegimi i simboleve

Kështilla sigurie

Tek kështillat paralajmëruese, fjalët sinjalizuese karakterizojnë llojin dhe ashpërsinë e pasojave, nëse nuk respektohen masat për parandalimin e rreziqeve.

Fjalët e mëposhtme sinjalizuese janë të përcaktuara dhe mund të jenë përdorur në dokumentin që keni para:

RREZIK

RREZIK do të thotë që mund të shkaktohen dëme të rënda dhe deri me rrezik për jetën.

PARALAJMËRIM

PARALAJMËRIM do të thotë që mund të shkaktohen dëme të rënda deri në rrezik për jetën.

KUJDES

KUJDES do të thotë që mund të shkaktohen dëme të lehta deri të mesme të rënda në persona.

KËSHILLË

KËSHILLË do të thotë që mund të shkaktohen dëme materiale.

Informacione të rëndësishme

Informacionet e rëndësishme pa rreziqe për njerëzit ose sendet shënohen me simbolin informues Info.

Simboli	Kuptimi
	Paralajmërim për substancat e djegshme: freoni R32 në këtë produkt është një gaz me djegshmëri të ulët dhe toksicitet të ulët (A2L ose A2).
	Mbani doreza mbrojtëse gjatë punimeve të instalimit dhe të mirëmbajtjes.
	Mirëmbajtja duhet kryer nga një person i kualifikuar në përputhje me udhëzimet në manualin e mirëmbajtjes.
	Respektoni udhëzimet e manualit të përdorimit gjatë punës.

tab. 1

1.2 Kështilla të përgjithshme sigurie

⚠ Udhëzime për grupin e synuar

Ky manual synohet për përdoruesit e sistemit të kondicionerit. Duhet të respektohen udhëzimet në të gjitha manualet në lidhje me impiantin. Në rast mosrespektimi mund të rezultojnë dëme materiale dhe lëndime në persona deri në rrezikim për jetën.

- ▶ Lexojini dhe ruajini manualet e përdorimit për të gjithë komponentët e sistemit përpara përdorimit.
- ▶ Respektoni kështillat e mëposhtme të sigurisë dhe të mirëmbajtjes.

⚠ Përdorimi në përputhje me qëllimin e duhur

Njësia e brendshme synohet për instalim brenda ndërtesës me lidhje drejt një njësie të jashtme dhe komponentëve të tjerë të sistemit, p.sh. rregullatorë.

Njësia e jashtme synohet për instalim jashtë ndërtesës me lidhje drejt një a më shumë njësive të brendshme dhe komponentëve të tjerë të sistemit, p.sh. rregullatorë.

Kondicioneri synohet vetëm për përdorim komercial/privat, ku devijimet e temperaturës nga vlerat e përcaktuara nuk shkaktojnë dëme për gjallesat apo materialet. Kondicioneri nuk është i përshtatshëm për rregullimin dhe ruajtjen precize të lagështirës së dëshiruar absolute.

Çdo përdorim tjetër konsiderohet në kundërshtim me përdorimin e parashikuar. Përdorimi i papërshtatshëm dhe dëmet si pasojë e këtij përjashtohen nga detyrimet tona.

Për instalimin në vende të posaçme (garazhe nëntokësore, salla tenike, ballkone apo në ambiente gjysmë të hapura):

- ▶ Fillimisht kini parasysh kërkesat për vendin e instalimit të përcaktuara në dokumentacionin teknik.

⚠ Rreziqet e përgjithshme nga freoni

- ▶ Kjo pajisje është e mbushur me freon. Gazi i freonit mund të shkaktojë gaze toksike kur bie në kontakt me zjarrin.
- ▶ Kontrolloni rregullisht sistemin nga një specialist i lecensuar dhe lëreni të presë.
- ▶ Nëse ka dyshim për rrjedhje freoni, ajroseni mirë ambientin dhe njoftoni specialistin e miratuar.

⚠ Restaurimi dhe riparimet

Modifikimet e papërshtatshme të sistemit të kondicionerit mund të shkaktojnë lëndime dhe/ose dëmtime të pronës.

- ▶ Kryeni punime vetëm nga një kompani të licencuar.
- ▶ Mos u bëni modifikime njësisë së jashtme, të brendshme apo pjesëve të tjera të sistemit të kondicionerit.
- ▶ Hiqeni kondicionerin nga korrenti përpara të gjitha punëve të mirëmbajtjes.

⚠ Këshilla për administrimin e sistemit

Përdorimi i gabuar i kondicionerit mund t'ju cenojë shëndetin.

- ▶ Mos e ekspozoni trupin drejtpërdrejt në rrymën e ajrit për periudha të gjata kohe.
- ▶ Për foshnjat, fëmijët, të moshuarit, personat në shtrat apo invalidë, sigurohuni që temperatura e ambientit të jetë e përshtatshme për ata që ndodhen në ambient.
- ▶ Mos fusni kurrë sende në pajisje, mund të lëndoheni.

Keqpërdorimi i pajisjes mund të sjellë rënie të rendimentit, si dhe dëmtim të pajisjes dhe lëndim.

- ▶ Mos i bllokoni hyrjet dhe daljet e ajrit të pajisjeve.
- ▶ Mbyllini dyert dhe dritaret gjatë funksionimit.
- ▶ Mbrojeni njësinë e brendshme nga hyrja e ujit.
- ▶ Kontrollojeni rregullisht skeletin e montimit të njësisë së jashtme për konsumim dhe fiksimin e duhur.
- ▶ Mos ushtroni peshë mbi njësinë e jashtme, p.sh. me objekte apo persona.
- ▶ Mbajini në minimum pluhurin, avujt dhe lagështinë në ambientin e instalimit të njësisë së brendshme.
- ▶ Mos përdorni gaze që digjen lehtësisht pranë pajisjeve, si p.sh. nga kënaçet spërkatëse.
- ▶ Nëse diçka nuk ju duket në rregull me kondicionerin (p.sh. erë e djegur, kabllo me defekt), ndalojeni funksionimin dhe hiqeni menjëherë nga korrenti.

⚠ Siguria e pajisjeve elektrike për përdorimin në shtëpi dhe për qëllime të ngjashme

Për mënjanimin e rreziqeve nga pajisjet elektrike vlejnë në përputhje me EN 60335-1 standardet e mëposhtme:

„Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë mbi 8 vjeç ose nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijore ose mendore, ose me mungesë përvoje dhe dijesh nëse ata mbahen nën vëzhgim ose udhëzohen në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes dhe kuptojnë rreziqet që lindin nga përdorimi i saj. Fëmijët nuk lejohen të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajta nga ana e përdoruesit nuk lejohet të kryhet nga fëmijët pa qenë nën vëzhgim.“

„Nëse dëmtohet linja e lidhjes në rrjet, ajo duhet zëvendësuar nga prodhuesi ose shërbimi i tij i klientit ose një person me kualifikim të ngjashëm, për të mënjanuar rreziqet.“

1.3 Shënimet në këtë manual

Figurat mund të gjenden të përmbledhura në fund të këtij manuali. Teksti përmban referenca për tek ilustrimet.

Produktet mund të ndryshojnë në varësi të modelit të shfaqur në këtë manual.

2 Të dhëna për produktin

2.1 Deklarata e konformitetit

Ndërtimi dhe funksionimi i këtij produkti është në përputhje me direktivat evropiane dhe kriteret plotësuese këmbëtare.

CE Me markimin CE shpjegohet konformiteti i produktit me të gjitha rregullat e zbatueshme ligjore të BE-së, të cilat parashikojnë vendosjen e këtij markimi.

Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit është i disponueshëm në internet: www.bosch-homecomfort.gr.

2.2 Të dhënat teknike të telekomandës

Ushqimi elektrik	2 bateri AAA
Rrezja e sinjalit	8 m
temperatura e lejueshme e ambientit	-5 °C ... 60 °C

tab. 2

2.3 Përdorimi me kondicioner Multi-Split

Njësia e brendshme mund të përdoret në një sistem me kondicioner Multi-Split. Në këtë rast, funksionet e mëposhtme janë joaktive:

- Funksionet e kursimit të energjisë **Save+** dhe **Power control**
- Vetëpastrimi (iClean 56°C)
- Reduktimi i zhurmës (Silent Mode)
- Puna manuale
- Zbulimi i rrjedhjes së freonit
- Modaliteti automatik i kursimit të energjisë kur është në gjendje pasive (1 W standby)

2.4 Specifikimet e portëkalimit IP

	Njësia	Vlera
U	V_{DC}	5
P_{max}	W	2,5
f (RF)	GHz	2.4 (802.11 b/g/n) (P = maks. + 20 dBm)
T_{amb}	°C	-20 ... 50
BUS	–	UART
Klasi i IP	–	IP40

tab. 3

3 Përdorimi


3.1 Përmbledhje e njësisë së brendshme

Legjenda e Fig. 1:

[1] Ekrani
[2] Paneli i parmë
[3] Grila e ajrit
[4] Filtrat e ajrit
[5] Butoni për përdorimin manual
[6] Sensori i lëvizjes (Human sensor)
[7] Paneli i rrjedhës së ajrit

Ekrani i njësisë së brendshme

Ekrani i njësisë së brendshme mbetet i fikur si parazgjedhje, duke u ndezur për 15 sekonda vetëm kur përdorni telekomandën. Kjo veçori ka për qëllim kursimin e energjisë.




Simboli	Shpjegimi
Numri	Shfaqja e temperaturës, funksioni i operimit dhe kodet e gabimit
	Lidhja WLAN aktive
	Shfaqet me disa funksione, nëse këto janë aktivizuar. Tregon që kohëmatësi i ndezjes është aktiv kur njësia e brendshme është e fikur.
0F	Shfaqet me disa funksione, nëse këto janë çaktivizuar.
dF	Shkrirja automatike është aktive
FP	Mbrojtja nga ngrica aktive: njësia e brendshme mban temperaturën e ambientit në minimum 8 °C.
CL	Funksioni i vetëpastrimit është aktiv (iClean 56°C)

tab. 4 Simbolet në ekranin e njësisë së brendshme

3.2 Përmbledhje e telekomandës


Tastet e telekomandës



Poz.	Tasti	Funksioni
1		Aktivizo/çaktivizo.
		Caktoni modalitetin e punës
		Save+
2		Menyja
	Ok	Konfirmo zgjedhjen
		Konfigurimi i kohëmatësit
		Rrit temperaturën
		Ul temperaturën
3		Shpejtësia e ventilatorit
		Lëkundje vertikale/horizontale
		Jonizuesi i avancuar
	Turbo	Modaliteti Turbo
	Silent	Modaliteti i heshtur
	Fjetje	Modaliteti i fjetjes
		Siguresa e fëmijëve

tab. 5 Tastet e telekomandës

Ekrani i telekomandës



Poz.	Simboli	Shpjegimi
1		Modaliteti: modaliteti automatik
		Modaliteti: modaliteti i ftohjes
		Modaliteti: modaliteti i ngrohjes
		Modaliteti: modaliteti i tharjes
		Modaliteti: modaliteti i ventilatorit
2		Temperatura e synuar
		Kohëmatësi AKTIV
		Kohëmatësi JOAKTIV
		Dërgimi i sinjalit
		Siguresa e fëmijëve
		Niveli i baterisë
	°C / °F / %RH	Shfaqja e vlerës: tregon temperaturën e synuar, % të lagështisë relative dhe kohëmatësin.
		Modaliteti i heshtur
		Shpejtësia e ventilatorit
		Modaliteti automatik i ventilatorit
		Modaliteti turbo i ventilatorit

Poz.	Simboli	Shpjegimi
3		Lëkundja vertikale - Auto
		Lëkundja horizontale - Auto
		Wind avoid me
		Jonizuesi i avancuar
		Modaliteti i fjetjes
		iClean 56°C
		Follow me
		Ekrani LED dhe alarmi aktiv/joaktiv
		Power control
		Save+
		Sensori për njerëz
		Ekrani i funksionit të komandimit me valë

tab. 6 Simbolet në ekranin e telekomandës

3.3 Përdorimi i telekomandës

Diapazoni i sinjalit është 8 m. Nëse ka objekte që pengojnë rrugën ose nëse përdoren llamba të caktuara fluoreshente në të njëjtën dhomë, kjo mund të ndikojë në transmetimin e sinjalit.

- Drejtojeni telekomandën drejt dritares së marrësit të sinjalit të pajisjes dhe shtypni tastin e dëshiruar.

KËSHILLË

Telekomanda mund të pengohet përgjithmonë të funksionojë siç duhet.

- Mos e ekspozoni telekomandën në rrezet e drejtpërdrejta të diellit.
- Mos e lini telekomandën pranë një pajisjeje ngrohëse.
- Mbrojeni telekomandën nga lagështia dhe goditjes.

3.4 Lidhjet

3.4.1 Lidhjet

Kontrolloni shumë lehtë funksionet më të rëndësishme nëpërmjet aplikacionit Bosch HomeCom Easy në pajisjen portative.

PARALAJMËRIM

Përdorim i gabuar!

Është rreptësisht e ndaluar që operatorit të hapë dhe të ndërhyjë me produktin përveç veprimeve të lejuara në këtë kapitull. Çdo përdorim i gabuar mund të rezultojë në rrezik për të zotin e shtëpisë dhe për vetë produktin!

Kërkesat teknike

Sistemi operativ	• Android • IOS
Router	Rrugëzues standard me sinjal 2,4 GHz
WLAN standard	IEEE 802.11b/g/n

tab. 7 Kërkesat teknike

Shkarkimi i aplikacionit

Aplikacioni mund të shkarkohet nga Apple App Store për iOS dhe Google Play Store për Android. Për të përfituar nga funksionet më të fundit dhe përditësimet e sigurisë, sigurohuni që të keni gjithmonë të instaluar versionin më të fundit në pajisjen portative.

- Skanoni kodin QR për të shkarkuar dhe instaluar aplikacionin.
- Konfiguroni llogarinë tuaj.
- Sigurohuni që të pranoni kushtet e përdorimit.



fig. 1

Çiftimi

Fuqia e sinjalit e WLAN është e mjaftueshme për të krijuar një lidhje me internetin. Nëse sinjali është shumë i dobët:

- Përdorni një repetitor WLAN.

- Ndizni njësinë e brendshme.
- Hapni aplikacionin dhe ndiqni hapin e përshkruar.
- Skanoni kodin QR për të çiftuar produktin.




fig. 2 HomeCom Easy

3.4.2 Mbështetja për Matter

Ky kondicioner është projektuar që të mbështesë protokollin Matter, duke siguruar integrim të shtruar me Alexa, Google Assistance, Apple Home ose pajisje të tjera që mbështesin Matter, për ndërveprim dhe lidhje të përmirësuar me ekosistemin e shtëpisë tuaj inteligjente.

Karakteristikat e mbështetura përfshijnë:

- Aktivizim-çaktivizimi i pajisjes
- Caktimi i modalitetit (ftohje, ngrohje, tharje, ventilator, automatik)
- Monitorimi i temperaturës së ambientit
- Caktimi i temperaturës së ambientit
- Caktimi i shpejtësisë së ventilatorit

Veçoritë e ofruara mund të ndryshojnë në bazë të llojit të pajisjes me mbështetje për Matter.

Për udhëzime specifike për lidhjen dhe përdorimin e pajisjeve të tjera që mbështesin Matter, konsultohuni me manualet përkatëse të përdorimit ose dokumentacionin që vjen me ato pajisje.

3.4.3 Funksioni i monitorimit të energjisë

Veçoria e monitorimit të energjisë ju mundëson të ndiqni konsumin e korrentit të secilës njësi të brendshme, ndarë sipas modalitetit. Nëpërmjet ekranit të përfshirë të shkallës së efikasitetit, mund të krahasoni konsumin e korrentit me kapacitetin e energjisë termike për ngrohje ose ftohje. Për më tepër, konsumi total i energjisë elektrike dhe kapaciteti total i energjisë termike gjatë jetës së pajisjes regjistrohet për ju.

Vizualizimi i të dhënave të monitorimit të energjisë kërkon një llogari aktive të aplikacionit.

3.5 Caktimi i modalitetit kryesor

Ndezja/fikja e njësisë

- Shtypni tastin ⏻ për të ndezur ose fikur njësinë:
  Njësia ndizet në modalitetin e caktuar.

Cilësimet mund të zgjidhen gjithashtu kur njësia është e fikur. Njësia ruan cilësimet dhe gjithashtu i ruan ato në rast të ndërprerjes së korrentit.

Pas fikjes, njësia mbetet në modalitetin e pasiv. Teknologjia inteligjente e ndezje-fikjes mundëson një modalitet automatik kursimi energjie kur është në modalitetin pasiv (1 W standby).

Modaliteti automatik

Në modalitetin automatik, njësia kalon automatikisht ndërmjet modalitetit të ngrohjes dhe të ftohjes për të ruajtur temperaturën e dëshiruar.

- Shtypni disa herë tastin ⇄ derisa të shfaqet në ekran A.
- Zgjidhni temperaturën e kërkuar me tastet ∧ dhe ∨.

Shpejtësia e ventilatorit nuk mund të rregullohet në modalitetin automatik.

Modaliteti i ftohjes

- Shtypni disa herë tastin ⇄ derisa në ekran të shfaqet ❄.
- Zgjidhni temperaturën e kërkuar me tastet ∧ dhe ∨.
- Shtypni tastin derisa të arrihet shpejtësia e kërkuar e ajrit.

Modaliteti i ventilatorit

- Shtypni disa herë tastin ⇄ derisa të shfaqet në ekran .
- Shtypni tastin derisa të arrihet shpejtësia e kërkuar e ventilatorit.

Temperatura nuk mund të rregullohet ose shfaqet në modalitetin e ventilatorit.

Modaliteti i tharjes

- Shtypni disa herë tastin ⇄ derisa në ekran të shfaqet .
- Zgjidhni temperaturën e kërkuar me tastet ∧ dhe ∨.

Ndryshoni përqindjen e lagështisë për të ruajtur nivelin minimal të dëshiruar të lagështisë gjatë modalitetit të tharjes:

- Shtypni disa herë tastin ☰ derisa në ekran të shfaqet **%RH**.
- Konfirmoni me tastin **Ok**.
- Shtypni tastet ∧. dhe ∨ derisa të shfaqet përqindja e dëshiruar e lagështisë relative. Diapazoni i cilësimeve është 35–85% në hapa 5%.
  Lagështia e caktuar shfaqet në ekranin e telekomandës.

Ky funksion nuk është krijuar për të rritur lagështinë. Është menduar posaçërisht për heqjen e lagështisë.

Shpejtësia e ventilatorit nuk mund të rregullohet apo shfaqet në modalitetin e tharjes.

Modaliteti i ngrohjes

- Shtypni disa herë tastin ⇄ derisa në ekran të shfaqet ☼.
- Caktoni temperaturën e kërkuar me tastet ∧ dhe ∨.
- Shtypni tastin derisa të arrihet shpejtësia e kërkuar e ventilatorit.

Nëse temperatura e jashtme është shumë e ulët, kapaciteti i ngrohjes së sistemit të kondicionerit mund të mos jetë i mjaftueshëm. Ju rekomandojmë lidhjen e burimeve shtesë të ngrohjes.

3.6 Konfigurimi i kohëmatësit

Kohëmatësit e ndezjes/fikjes mund të caktohen midis 0 dhe 24 orëve, me rritje 30-minutëshe për 10 orët e para, pastaj rritje 1-orëshe. Nëse caktohet 0 orë, kohëmatësi anulohet.

Caktimi i kohëmatësit të ndezjes

- Shtypni tastin derisa të shfaqet simboli ON.
- Shtypni tastin ∧ ose ∨ për të caktuar kohën e dëshiruar.
  Cilësimi zbatohet menjëherë më pas.

Caktimi i kohëmatësit të fikjes

- Shtypni tastin derisa të shfaqet simboli OFF.
- Shtypni tastin ∧ ose ∨ për të caktuar kohën e dëshiruar.
  Cilësimi zbatohet menjëherë më pas.

Anulimi i kohëmatësit

- Shtypni tastin për të zgjedhur kohëmatësin përkatës.
- Caktoni 0.0 orë.
  Kohëmatësi anulohet pas një kohe të shkurtër.

Kombinimi i kohëmatësve

Dy kohëmatës mund të caktohen në të njëjtën kohë. Secili kohëmatës mund të programohet të aktivizohet përpara tjetrit

- Vendosni kohëmatësin e ndezjes dhe të fikjes.
  Cilësimet do të kombinohen automatikisht.

Ora aktuale	13:00
Caktimi i kohëmatësit të ndezjes	4.0 h
Caktimi i kohëmatësit të fikjes	8.5 h
Koha e ndezjes	17:00
Koha e fikjes	21:30

tab. 8 Shembull

Nuk mund ta programoni kohëmatësin e ndezjes dhe të fikjes për të përdorur njësinë në temperatura të ndryshme apo me cilësime të tjera.

3.7 Funksionet kryesore të operimit

3.7.1 Funksioni i kursimit të energjisë

Funksioni i mëposhtëm i kursimit të energjisë mund të zgjidhet në pajisje:

Save+

Njësia redukton automatikisht konsumin e energjisë, duke ruajtur temperaturën e dëshiruar të dhomës.

- Shtypni tastin për ta aktivizuar këtë veçori.
  Telekomanda shfaq simbolin .

Funksioni **Save+** mund të zgjidhet vetëm në modalitetet e ftohjes dhe të ngrohjes.

Shtypja e tastit do të ndalojë funksioninimin e **Save+**.

3.7.2 Caktimi i funksionit të lëkundjes

KËSHILLË

Nëse penda qëndron në pozicionin më të ulët gjatë modalitetit të ftohjes për një periudhë të gjatë, mund të formohet kondensat. Rregullimi i pendës me dorë mund të shkaktojë avari.

- Përdorni vetëm telekomandën për të rregulluar pendën.

Funksioni i lëkundjes mund të aktivizohet në pozicionin vertikal ose horizontal (→ 2).

Modaliteti automatik i lëkundjes vertikale (lart/poshtë)

- Shtypni tastin .
  Telekomanda shfaq simbolin .

Për të anuluar modalitetin automatik të lëkundjes vertikale:

- Shtypni sërish tastin .

Rrotullimi i pendës me dorë (lart/poshtë)

- Shtypni disa herë tastin derisa të caktohet pozicioni i kërkuar.
  Cilësimi ndryshon me radhën e mëposhtme:



Modaliteti automatik i lëkundjes horizontale (majtas/djathtas)

- Shtypni tastin për 2 sekonda për të aktivizuar modalitetin automatik të lëvizjes horizontale.
  Telekomanda shfaq simbolin .

Për të anuluar modalitetin automatik të lëkundjes horizontale:

- Shtypni përsëri tastin për dy sekonda.

Kur ndizni njësinë, pozicioni i pendës do të rifillojë automatikisht në këndin e vet të mëparshëm.

Advanced Ionizer (Funksioni i ajrit të jashtëm)

Kur zgjidhet ky funksion, një komponent i brendshëm i njësisë së brendshme do të aktivizohet dhe jonet e çliruara do të shpërndahen në dhomë për të luftuar ndotësit në ajër si myku, viruset dhe alergjenët, duke ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm.

- Shtypni tastin për të aktivizuar këtë funksion.
  Telekomanda shfaq simbolin .

Dalja nga funksioni:

- Shtypni sërish tastin .

3.7.3 Turbo cool/Turbo heat

Kur Turbo cool/Turbo ngrohje është aktiv, njësia e brendshme funksionon me fuqinë maksimale për 30 min për të ngrohur ose ftohur dhomën shpejt.

- Turbo cool: aktivizoni modalitetin e ftohjes dhe shtypni tastin **Turbo**.
- Turbo heat: aktivizoni modalitetin e ngrohjes dhe shtypni tastin **Turbo**.
  Telekomanda shfaq simbolin .

Dalja nga funksioni:

- Shtypni përsëri tastin **Turbo**.
  Simboli në telekomandë zhduket.

Ky funksion disponohet vetëm në modalitetet e ftohjes dhe të ngrohjes.

3.7.4 Silent Mode

Ky funksion redukton zhurmat e lëshuara nga njësia e brendshme dhe e jashtme kur është në punë. Kjo është veçanërisht e dobishme gjatë natës, nëse duhet të tregoni konsideratë për fqinjët tuaj.

- Shtypni butonin **Silent** për të aktivizuar këtë funksion.
  Telekomanda shfaq simbolin .

Dalja nga funksioni:

- Shtypni përsëri tastin **Silent**.
  Simboli në telekomandë zhduket.

Shpejtësia e ventilatorit të njësisë së brendshme do të reduktohet në nivelin minimal. Nëse vendosni një shpejtësi më të lartë të ventilatorit për njësinë e brendshme, funksioni i modalitetit të heshtur do të çaktivizohet.

Kur njësia është në modalitetin e heshtur, mund të mos jetë e mundur të arrihet kapaciteti i kërkuar i ftohjes/ngrohjes sepse kompresori në njësinë e jashtme funksionon me frekuencë të ulët.

3.7.5 Modaliteti i fjetjes

Qëllimi i këtij funksioni është të kursejë energji gjatë kohës pa punë. Pas një ore, pajisja ngroh ose ftoh jo aq fort. Për ta bërë këtë, temperatura e synuar ndryshohet me 1 °C. Pas dy orësh, temperatura e synuar ndryshon me 1 °C tjetër. Pastaj qëndron në temperaturën e re.

Për të aktivizuar funksionin:

▶ Shtypni tastin **Sleep**.
Telekomanda shfaq simbolin .

Për të çaktivizuar funksionin:

▶ Shtypni përsëri tastin Sleep ose pas 8 orësh funksionimi në modalitetin e fjetjes.
Simboli në telekomandë zhduket.

Funksioni nuk ofrohet në modalitetin e tharjes dhe të ventilatorit.

3.7.6 Funksioni i siguresë së fëmijëve

Tastet e telekomandës mund të kyçen me siguresën e fëmijëve.

Për të aktivizuar funksionin:

▶ Shtypni tastet **Turbo** dhe **Sleep** njëherësh për 5 sekonda.
Telekomanda shfaq simbolin .

Për të çaktivizuar funksionin:

▶ Shtypni tastet **Turbo** dhe **Sleep** njëherësh për 3 sekonda.
Simboli në telekomandë zhduket.

3.7.7 Mbrojtje nga ngrica (8 °C / 12 °C)

Mbrojtja nga ngrica mund të aktivizohet për të mbajtur temperaturën e ambientit në një minimum prej 8 °C.

▶ Në modalitetin e ngrohjes, caktojeni temperaturën në 16 °C.
▶ 8 °C: Shtypni tastin ∨ 2 herë brenda 1 sekonde.
▶ 12 °C: Shtypni tastin ∨ 2 herë brenda 1 sekonde.
Njësia qëndron e fikur derisa temperatura të bjerë nën 8 °C/12 °C.

Dalja nga funksioni:

▶ Shtypni tastin , tastin ose ndonjë tast tjetër.

Në ekranin e njësisë së brendshme shfaqet **Fp** kur funksioni i mbrojtjes nga ngrica është aktiv.

3.7.8 Funksione të tjera

▶ Shtypni tastin .
▶ Shtypni disa herë tastin ose tastet ∧, ∨ për të zgjedhur funksionin.
– = funksioni i ndezje-fikjes LED
– = funksioni Power control
– = funksioni Human sensor
– = Wind avoid me (funksioni i rrjedhjes indirekte të ajrit)
– = iClean 56°C
– = funksioni Follow me
– = funksioni i kontrollit me valë
▶ Konfirmoni zgjedhjen me tastin **Ok**.

Dalja nga funksioni:

▶ Përsëritni hapat e mësipërm.

Ndryshimi i ekranit dhe sinjalizuesi i alarmit (Mute Mode)

Për të ndezur ose fikur ekranin në njësinë e brendshme dhe sinjalizuesin e alarmit:

▶ Shtypni disa herë tastin ose tastet ∧, ∨ derisa të shfaqet ikona .
▶ Konfirmoni zgjedhjen me tastin **Ok**.

Për të shfaqur temperaturën aktuale të ambientit:

▶ Shtypni butonin **Silent** dhe mbajeni për 5 sekonda.

Për të shfaqur temperaturën e synuar:

▶ Shtypni e mbani butonin **Silent** për 5 sekonda të tjera.

Power control

Ofrohen opsionet e mëposhtme për kontrollin e korrentit. Dy nga opsionet e kontrollit të korrentit mund të zgjidhen për të reduktuar konsumin e energjisë së pajisjes:

- **Power control** (100%): operim normal (dilni nga funksioni Power control)
- **Power control** (75%): reduktoni konsumin e korrentit me 25%
- **Power control** (50%): reduktoni konsumin e korrentit me 50%

Për të zgjedhur opsionin e dëshiruar të kontrollit të korrentit:

▶ Shtypni disa herë tastin ose tastet ∧, ∨ derisa të shfaqet .
▶ Konfirmoni me tastin **Ok**.
▶ Shtypni ∧ dhe ∨, dhe zgjidhni nivelin e dëshiruar të kontrollit të korrentit (100%, 75%, 50%).
▶ Konfirmoni me tastin **Ok**.

Funksioni **Power control** mund të zgjidhet vetëm në modalitetin e ftohjes.

Funksioni i sensorit të lëvizjes (sensori për njerëz)

Pajisja e brendshme ka një sensor lëvizjeje të vendosur në anën e pasme të panelit ballor. Sensori zbulon objektet në lëvizje në një dhomë për të përcaktuar veprime njerëzish.

Nëse sensori nuk zbulon asnjë lëvizje në dhomë për 30 minuta, njësia ul fuqinë. Kur rizbulohet lëvizje në dhomë, fuqia rritet në operim normal.

Sensori për njerëz (→ 3, [2]) zbulon brenda një rrezeje prej 6 metrash [B], me një zonë të verbër 1 metër [A] dhe një zonë zbulimi 5 metra [1]. Gjithashtu ka një kënd zbulimi prej 2,5 metrash nga qendra e kondicionerit deri tek anët (funksioni i lëkundjes) (→ 4).

▶ Shtypni disa herë tastin ose tastet ∧, ∨ derisa të shfaqet ikona .
▶ Konfirmoni zgjedhjen me tastin **Ok**.

Fshesat robotike, ventilatorët rrotullues, bimët dhe perdet që fryhen nga era etj., të gjitha identifikohen si veprime njeriu dhe mund të rezultojnë në dështimin e funksioneve të kursimit të energjisë kur nuk ka faktikisht njerëz në ambient.

Wind avoid me (funksioni i rrjedhës indirekte të ajrit)

Ky funksion parandalon një rrjedhje të drejtpërdrejtë të ajrit në trup.

▶ Shtypni disa herë tastin ose tastet ∧, ∨ derisa të shfaqet ikona .
▶ Konfirmoni zgjedhjen me tastin **Ok**.

Funksioni ofrohet vetëm në modalitetin e ftohjes, modalitetin e heqjes së lagështirës dhe modalitetin e ventilatorit.

iClean 56°C
Njësia ka një funksion vetëpastrimi për shkëmbyesin e nxehtësisë të ambientit të brendshëm. Funksioni i vetëpastrimit heq pluhurin, mykun dhe yndyrën që mund të shkaktojnë erëra të pakëndshme. Funksionon duke e ngrirë automatikisht, duke shkrirë shpejt ngricën dhe më pas duke përdorur ajër të nxehtë për të tharë shkëmbyesin, duke eliminuar me efikasitet këto papastërti.

- ▶ Shtypni disa herë tastin ☰ ose tastet ∧, ∨ derisa të shfaqet ikona .
- ▶ Konfirmoni zgjedhjen me tastin **Ok**.

Në ekranin e njësisë së brendshme shfaqet **CL** kur kryhet vetëpastrimi. Vetëpastrimi përfundon automatikisht pas 20–45 minutash.

Funksioni Follow me (Follow Me)
Funksioni aktivizon telekomandën në vendndodhjen aktuale për të matur temperaturën në intervale 3-minutëshe. Njësia e brendshme tani kontrollohet duke iu referuar këtyre matjeve.

- ▶ Shtypni disa herë tastin ☰ ose tastet ∧ dhe ∨ derisa të shfaqet ikona .
- ▶ Konfirmoni zgjedhjen me tastin **Ok**.

Funksioni Follow Me ofrohet vetëm në modalitetin e ftohjes, modalitetin e ngrohjes dhe modalitetin automatik.

Funksioni i kontrollit me valë
Qëllimi i këtij funksioni është të krijojë një lidhje nëpërmjet WLAN. Nëse njësia nuk e shfaq funksionin:

- ▶ Shtypni disa herë tastin ☰ ose tastet ∧ dhe ∨ derisa të shfaqet .
- ▶ Konfirmoni zgjedhjen me tastin **Ok**.

4 Zgjidhja e problemeve

4.1 Gabimet me tregues (Self diagnosis function)

Nëse ndodhin gabime gjatë funksionimit, llambat pulsojnë për një periudhë të zgjatur kohe ose ekrani tregon një kod gabimit (p.sh. EH 02).

Nëse ndodh një gabim për më shumë se 10 minuta:

- ▶ Ndërprisni korrentin për pak dhe ndizeni sërish njësinë e brendshme.

Kur një defekt nuk mund të mënjanohet:

- ▶ Telefonojini shërbimit të klientit dhe jepini kodin e gabimit dhe të dhënat pajisjes.

4.2 Gabime pa tregues

Nëse ndodhin gabime gjatë funksionimit të cilat nuk mund të shmangen:

- ▶ Telefonojini shërbimit të klientit dhe raportoni gabimin dhe të dhënat e pajisjes.

Problemi	Shkaku i mundshëm
Rendimenti i njësisë së brendshme është shumë i dobët.	Temperatura e caktuar është shumë e lartë ose e ulët.
	Filtri i ajrit është i ndotur dhe duhet pastruar.
	Ndikim i pafavorshëm i ambientit mbi njësinë e bendshme, p.sh. për shkak të pengesave përpara daljeve të ajrit të pajisjeve, për shkak të dyerve/dritareve të hapura në ambient apo për shkak të burimeve të forta të nxehtësisë në ambient.
	Funksionimi me zhurmë të ulët është aktivizuar dhe pengon fuqinë e plotë.
Njësia e brendshme nuk ndizet.	Njësia e brendshme ka një mekanizëm mbrojtës kundër mbingarkimit. Rindezja e njësisë së brendshme mund të marrë 3 minuta.
	Kanë rënë bateritë e telekomandës.
	Është aktivizuar kohëmatësi.
Modaliteti i punës ndryshon nga ftohja apo ngrohja në modalitet ventilatori.	Njësia e brendshme ndryshon modalitetin e punës për të parandaluar formimin e brymës.
	Temperatura e caktuar arrihet përkohësisht.
Njësia e brendshme krijon mjegull të bardhë.	Në rajone me lagështirë, diferenca e madhe në temperaturë mes njësisë së brendshme dhe ajrit të kondicionuar mund të shkaktojë mjegull të bardhë.
Njësia e brendshme dhe njësia e jashtme krijojnë mjegull të bardhë.	Nëse modaliteti i ngrohjes punon direkt pas shkrirjes automatike, mund të krijohet mjegull e bardhë për shkak të lagështisë së shtuar.
Njësia e brendshme dhe e jashtme bëjnë zhurmë.	Një zhurmë si fishkëllimë në njësinë e brendshme mund të ndodhë kur rrjeta e ajrit rivendos pozicionin e vet.
	Një fishkëllimë e lehtë gjatë funksionimit është normale. Kjo shkaktohet nga rrjedhja e freonit.
	Një zhurmë kërcitëse mund të ndodhë kur pjesët metalike dhe plastike të pajisjes bymehen apo tkurren gjatë ngrohjes/ftohjes.
	Njësia e jashtme bën zhurma të ndryshme gjatë punës, që janë normale.
Njësia e brendshme ose e jashtme lëshon pluhur.	Për periudha të gjata të lëna pa punë mund të mblidhet pluhur në pajisje nëse nuk e mbuloni.
Erë jo e mirë gjatë funksionimit.	Erërat e këqija nga ajri mund të penetrojnë e të përhapen nëpër pajisje.
	Filtri i ajrit mund të ketë marrë myk dhe duhet pastruar.
Ventilatori i njësisë së jashtme nuk punon gjithë kohës.	Për funksionim optimal, ventilatori kontrollohet me tjetër formë.

Problemi	Shkaku i mundshëm
Funksionimi është i çrregullt ose i paparashikueshëm ose njësia e brendshme nuk reagon.	Interferenca nga stacionet celulare ose amplifikatorët e sinjaleve të palëve të treta mund të ndikojnë mbi njësinë e brendshme. ▶ Shkëputeni dhe riniseni njësinë e brendshme për një kohë të shkurtër.
Penda e ajrit ose fleta e lëvizjes së ajrit nuk lëviz siç duhet.	Penda e ajrit ose fleta e lëvizjes së ajrit është rregulluar me dorë ose nuk është montuar siç duhet. ▶ Fikeni njësinjë e brendshme dhe kontrolloni nëse komponentët janë kyçur mirë në vend. ▶ Ndizni njësinë e brendshme.

tab. 9

5 Mirëmbajtja

KUJDES

Rreziku nga elektroshoku ose pjesët lëvizëse

- ▶ Hiqeni nga korrenti përpara të gjitha punimeve të mirëmbajtjes.
- ▶ Hapat e mirëmbajtjes që nuk përmenden këtu kryejini vetëm nga një kompani e specializuar e miratuar.

5.1 Ndërrimi i baterive

Ju duhen 2 bateri të madhësisë AAA. Nuk rekomandohet përdorimi i baterive të karikueshme.

- ▶ Hiqni kapakun e folesë së baterive (→ figura 5).
- ▶ Futni bateritë e reja dhe kushtojini kujdes polaritetit të saktë.
- ▶ Rivendosni kapakun e folesë së baterive.

5.2 Pastrimi i pajisjes dhe i telekomandës

KËSHILLË

Pajisja mund të dëmtohet nëse nuk pastrohet saktë!

- ▶ Mos e spërkatni e mos i hidhni ujë drejtpërdrejt.
- ▶ Mos përdorni ujë të ngrohtë, pluhur abraziv apo solucione të forta.

- ▶ Fshijeni njësinë e brendshme dhe telekomandën me një lecktë të butë.
- ▶ Pastrojeni njësinë e jashtme vetëm nga një kompani e specializuar e miratuar.

5.3 Pastrimi i filtrit të ajrit

KËSHILLË

Filtri i ajrit mund të deformohet nën rrezet e drejtpërdrejta të diellit.

- ▶ Mos e ekspozoni filtrin e ajrit në rrezet e drejtpërdrejta të diellit.

Pastrojeni filtrin e ajrit çdo 2 javë, si dhe para dhe pas çaktivizimit për periudha më të gjata.

- ▶ Fikeni njësinë e brendshme.
- ▶ Palosni për lart kapakun e parmë të njësisë së brendshme → Fig. 6, [1]).
- ▶ Hiqni grilat e ajrit dhe nxirrni nga njësia (→ Fig. 6, [2]).
- ▶ Hiqni filtrat e ajrit nga grilat, nëse janë të instaluar (→ Fig. 6, [3]).
- ▶ Pastrojini filtrat e vegjël të ajrit me një fshesë me korrent.
- ▶ Lajeni filtrin e madh të ajrit me ujë të ngrohtë dhe detergjent të butë dhe thajeni në hije.
- ▶ Rivendosni filtrin e vogël të ajrit dhe filtrin e madh të ajrit.

5.4 Lënia pa punë për kohë më të gjatë

Përpara fikjes për kohë të gjatë:

- ▶ Pastrojini filtrat e ajrit.
- ▶ Aktivizoni vetëpastrimin e njësisë së brendshme me tastin **Clean**.
- ▶ Pas vetëpastrimit aktivizoni modalitetin e ventilatorit derisa njësia e brendshme të thahet.
- ▶ Fikeni pajisjen e brendshme dhe shkëputeni nga korrenti.
- ▶ Hiqini bateritë nga telekomanda.
- ▶ Mbrojini pajisjet nga pluhuri.

5.5 Puna manuale

KËSHILLË

Dëmtimi i njësive për shkak të përdorimit të gabuar

Përdorimi i vazhdueshëm i funksionimit manual nuk është parashikuar nga prodhuesi.

- ▶ Kjo zgjidhje duhet të përdoret vetëm për qëllime testimi ose në raste urgjente.
- ▶ Përdoreni vetëm për kohë të shkurtër.

- ▶ Fikeni njësinë e brendshme.
- ▶ Paloseni për lart kapakun e sipërm të njësisë së brendshme.
- ▶ Gjeni butonin e kontrollit manual në anën e djathtë të kutisë së ekranit (→ 7).
- ▶ Shtypni tastin për modalitetin e kontrollit manual duke futur një send të hollë:
  - – Shtypni një herë: njësia kalon me forcë në modalitetin automatik.
  - – Shtypni dy herë: njësia kalon me forcë në modalitetin e ftohjes.
  - – Shtypni tre herë: njësia e brendshme fiket.
- ▶ Përdorni telekomandën për të rikthyer modalitetin normal.

6 Mbrojtja e ambientit dhe hedhja

Mbrojtja e ambientit është një parim i korporatës së grupit Bosch. Cilësia e produkteve, kursimi dhe mbrojtja e ambientit janë për ne objektive të të njëjtit nivel. Ligjet dhe rregulloret në lidhje me mbrojtjen e ambientit respektohet me rigorozitet.
Për mbrojtjen e ambientit, duke marrë parasysh pikëpamjet ekonomike, përdorim teknologjinë dhe materialet më të mira të mundshme.

Paketimi

Në rastin e paketimit ne përfshihemi në sistemet e riciklimit sipas specifikave të vendit përkatës, për të garantuar një ricikilim optimal. Të gjitha materialet e përdorura për paketimin nuk janë të dëmshme për ambientin dhe mund të riciklohen.

Pajisja e vjetër

Pajisjet e vjetra përmbajnë materiale me vlerë që mund të riciklohen. Pjesët mund të ndahen lehtë. Plastikat janë etiketuar. Në këtë mënyrë, pjesët e ndryshme mund të klasifikohen, të riciklohen ose të hidhen.

Pajisjet e vjetra elektrike dhe elektronike



Ky simbol do të thotë që produkti nuk duhet të hidhet me mbeturina të tjera, përkundrazi duhet të dërgohet në pikat e grumbullimit të mbeturinave për trajtim, grumbullim, riciklim dhe asgjësim.

Simboli është i vlefshëm në shtetet ku zbatohen rregulloret për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike, p.sh. "(MB) Rregulloret e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike 2013 (të ndryshuara)". Këto rregullore përcaktojnë kuadrin për kthimin dhe riciklimin e pajisjeve të vjetra elektronike që zbatohet në secilin shtet.

Meqenëse pajisjet elektronike mund të përmbajnë substanca të rrezikshme, ato duhet të riciklohen me përgjegjësi në mënyrë që të minimizohet çdo dëm i mundshëm në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Për më tepër, riciklimi i mbetjeve elektronike ndihmon në ruajtjen e burimeve natyrore.

Për informacion shtesë mbi asgjësimin ekologjik të pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike, ju lutemi të kontaktoni autoritetet përkatëse lokale, shërbimin tuaj të hedhjes së mbeturinave shtëpiake ose shitësin me pakicë ku keni blerë produktin.

Mund të gjeni më shumë informacion këtu:
www.bosch-homecomfortgroup.com/en/company/legal-topics/weee/

Bateritë

Bateritë nuk duhen hedhur me mbeturinat e shtëpisë. Bateritë e përdorura duhen hedhur në sistemet lokale të grumbullimit.

Freon R32



Pajisja përmban gaz të fluorinuar efekti serrë R32 (potenciali i efektit serrë 675[1)]) me djegshmëri dhe toksicitet të ulët (A2L ose A2).

Sasia e përmbajtur përcaktohet në pllakën e markës së njësisë së jashtme.

Freoni është rrezik për mjedisin dhe duhet grumbulluar e hedhur veçmas.

1) sipas shtojcë I të rregullores (BE) Nr. 517/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 16 prillit 2014.